



Republika e Kosovës – Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Qeveria – Blada – Government

Zyra e Kryeministrit – Канцеларија премијера – Office of the Prime Minister
Zyra për Çështje të Komuniteteve – Канцеларија за питања заједница – Office for Community Affairs

Ftesë për Propozime

Mbrojtja dhe promovimi i të drejtave dhe interesave të komuniteteve jo-shumicë - MPDIK

I. QËLLIMI I FTESËS

Qëllimi i kësaj ftese është si mbështetje për Zyrën për Çështje të Komuniteteve/Zyrën e Kryeministrit (ZÇK-ZKM) në zbatimin e misionit të saj. Misioni i zyrës është që të gjitha komunitetet¹ në Kosovë t'i gëzojnë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara për të gjithë qytetarët sipas legjislacionit në fuqi të Republikës së Kosovës, si dhe të drejtat shtesë që ua mundësojnë atyre ruajtjen e identitetit dhe kulturës së tyre si dhe pjesëmarrjen e tyre të plotë në shoqërinë kosovare.

Konkretisht, programi për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe interesave të komuniteteve jo-shumicë (**MPDIK**) përpiket që të adresojë boshllëqet rreth zbatimit të kornizës ligjore dhe politike për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve duke përmirësuar kapacitetin e grupeve të interesit drejt avancimit të pozitës së komuniteteve jo-shumicë dhe promovimit të bashkëpunimit ndërmjet qeverisë dhe organizatave joqeveritare.

Kjo ftesë për propozime është bërë në formë të shpalljes publike më qëllim që të gjitha organizatat e interesuara dhe të kualifikuara t'ju jepet mundësi dhe e drejtë për paraqitjen e kërkesave të tyre për financim të projektit. Për qëllimet e kësaj ftese për propozim, “organizatat” definohe si organizata kosovare joqeveritare, të bazuara në komunitet dhe/apo të bazuara në mirëbesim, si dhe në pjesëmarrje vullnetare.

II. OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME

Nëpërmjet programit të **MPDIK** -së, **ZÇK/ZKM**-ja përpiket që të adresojë nevojat e komuniteteve jo-shumicë dhe boshllëqet rreth zbatimit të legjislacionit dhe politikave që mbrojnë dhe promovojnë të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, me anë të partneritetit me autoritetet komunale dhe organizatave.

¹ Komunitetet jo-shumicë definohe si komunitete të cilat numerikisht janë pakicë në nivel komunal.

III. PËRSHKRIMI

III.1. REZULTATET E PRITURA TË PROGRAMIT TË “MPDIK” -së

Kjo ftesë për propozime është dizajnuar që të bëjë thirrje për ide për projektet që mbështesin objektivat e **MPDIK**-së. Që të shqyrtohen për financim, idetë e projektit duhet që detyrimisht të ndihmojnë në arritjen e rezultateve të mëposhtme:

- Angazhimin e përmirësuar ndërmjet autoriteteve komunale dhe komuniteteve në adresimin e një apo më shumë fushave të shqetësimit të komuniteteve;
- Vëmendjen e shtuar rreth çështjeve të ndërlidhura me femrat nga komunitetet (për shembull, shkalla më e lartë e përfshirjes së femrave në arsim, mundësitë e barabarta të femrave në punësim, përfaqësimi i gruas nga komunitetet etj.)

Përveç kësaj, idetë e projektit mund të përfshijnë një ose me shumë nga rezultate e mëposhtme:

- Kapacitetet e zgjeruara të autoriteteve komunale në zbatimin e kornizës ligjore dhe politike për komunitetet, në veçanti për sa i përket planifikimit strategjik;
- Zbatimin e shtuar të mbrojtës së të drejtave të komunitetet në një apo më shumë fusha, do të thotë, kundër-diskriminimit, sigurinë dhe lirinë e lëvizjes, të drejtat e identitetit, kulturës dhe religjionit, gjuhën, mediat, qasjen në arsim, mundësitë ekomomike dhe sociale, shëndetësinë, dhe/apo përfaqësimin;
- Zbatimin e shtuar të strategjive dhe veprimeve qeveritare që adresojnë apo ndikojnë tek komunitetet;
- Ngritjen e kualitetit të jetës të pjesëtarëve më të rrezikuar të komuniteteve jo-shumicë.

III.2. ELEMENTET E PËR PROGRAMIN E “MPDIK” -së

Aktivitetet e mundshme të projektit mund të përfshijnë, ndër të tjera:

- Ngritjen e kapaciteteve të komunave për zbatimin e politikave që kanë të bëjnë me komunitetet jo-shumicë;
- Ngritjen e mekanizmave të qëndrueshëm të angazhimit ndërmjet autoriteteve komunale dhe organizatave të shoqërisë civile;
- Promovimin e identiteteve jo-shumicë, kulturës, religjionit, dhe gjuhëve;
- Zhvillimin e mediave të reja dhe forcimin e mediave ekzistuese të komuniteteve;
- Mbështetjen për qasjen në arsim për pjesëtarët e komuniteteve jo-shumicë, si dhe ndërveprimin ndërmjet nxënësve dhe studentëve nga komunitetet e ndryshme;
- Zhvillimin e mundësive ekonomike për komunitetet dhe/apo pjesëtarëve të komuniteteve jo-shumicë respektivisht aftësimi i tyre në gjenerimin e të hyrave;
- Angazhimin e pjesëtarëve të komuniteteve, organizatave relevante nga shoqëria civile, dhe aktorëve nga niveli qendror i qeverisë në ushtrimin e aktiviteteve për përmirësimin e kualitetit të jetës së komuniteteve jo-shumicës;
- Angazhimin e shoqërisë civile, përfaqësuesve të qeverisë komunale, dhe/apo medieve në identifikimin e problemeve specifike të komuniteteve dhe në zhvillimin e propozimeve konkrete vepruese për përmirësimin e gjendjes në nivel lokal. Këto veprime duhet të kenë parasysh përfshirjen e institucioneve përkatëse të qeverisë në nivel qendror;

- Ndhimën në ndërlidhjen aktorëve me planet e ngjashme për çështjet në nivel lokal, më qëllim të kërkimit të zgjidhjeve nga niveli qendror.

Gjithashtu, projektet që mundësojnë dialogun ndëretnik dhe promovojnë shumë-etninë mund të kenë përparësi.

Përveç aktiviteteve të mësipërme, projektet që përfshijnë rininë, apo që adresojnë çështjet e të rinjve, do të konsiderohen në mënyrë pozitive, sikurse edhe projektet që kërkojnë angazhimin aktiv të grave si partnere dhe përfituese.

Po ashtu, projektet që promovojnë lidhjet dhe partneritetet ndërmjet një apo më shumë komuniteteve për përmirësimin e aftësive të këtyre komuniteteve, në adresimin e sfidave me të cilat ballafaqohen komunitetet e tyre dhe të cilat luftojnë për të drejtat e tyre, mund të konsiderohen si të favorshme.

Ndërlidhja dhe partneritetet nuk duhet të jenë të detyrueshme ose obligative, por vetëm të inkurajuar ashtu që të mund të ndodhin në mënyrë të natyrshme.

IV. UDHËZIME PËR APLIKANTËT

Në vijim janë udhëzimet e hollësishme për aplikantët e mundshëm:

Cilado pyetje në lidhje me këtë ftesë për propozime duhet të dorëzohet me shkrim me anë të postës elektronike në zck-kpz-grants@rks-gov.net, me temën vijuese “MPDIK”, apo në adresën e mëposhtme duke shkruar “MPDIK” mbi zarf:

Zyra për Çështje të Komuniteteve
Zyra e Kryeministrit
Ndërtesa e Qeverisë
Zyra 606
Rruga Nëna Terezë, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

IV.1. KUALIFIKIMET

ZÇK/ZKM-ja bën ftesë për aplikacione nga organizatat e regjistruara dhe me qëndrim në Kosovë, e që kanë përvojë në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të komuniteteve jo-shumicë dhe në rritjen e rolit të këtyre komuniteteve si grupe aktive të interesit në shoqëri. Aplikanti (aplikantët) më të suksesshëm janë ata të cilët kanë strukturat e organizuara.

Organizata me të drejtë aplikimi përshijnë organizatat joqeveritare, organizatat fetare të bazuara në mirëbesim dhe/apo konsorciumet e organizatave të lartpërmendura. Në rast të paraqitjes së projekt propozimit nga ana e konsorciumit së paku njëri partner duhet t’i plotësojë kërkesat e lartpërmendura për të pasur të drejtë pjesëmarrjeje.

Aplikantët duhet medoemos të jenë në gjendje që të ofrojnë dëshmi rreth kapacitetit programor, teknik dhe menaxherial, për t’i kryer aktivitetet e synuara, si dhe arritjen e rezultateve të suksesshme në të kaluarën në fushat e lartpërmendura.

Aplikantët duhet të krijojnë një partneritet me autoritetet komunale me qëllim të sigurimit të një ndikimi të qëndrueshëm të projektit.

Përveç kësaj, për të qenë minimalisht të pranueshëm për financim, aplikantët domosdo duhet t'u binden kushteve të mëposhtme:

1. Organizata duhet medoemos të ketë qenë aktive për më shumë se një vit. ZÇK/ZKM-ja mbanë të drejtën që t'i financojë organizatat që kanë ekzistuar e që kanë zbatuar programe për më pak se një vit. Këta aplikantë do të merren në konsideratë në baza rast-pas-rasti.
2. Organizata domosdo duhet të jetë në gjendje që të demonstrojë se ka burime tjera të financimit apo merr mbështetje nga komuniteti për të cilin punon dhe
3. Organizata medoemos duhet të ketë llogaridhënie themelore, menaxhim financiar dhe struktura për zbatimin e programit.

IV.2. AFATI I DORËZIMIT TË APLIKACIONEVE

Aplikacionet mund të dorëzohen, **çdo ditë pune nga 08:00h – 16:00h, prej datës 07 Prill 2016 deri më 21 Prill 2016**

Përzgjedhja e aplikacioneve do të bëhet brenda katër javësh pas afatit përfundimtar të dorëzimit. Komision i përbërë nga personeli i ZÇK/ZKM-së dhe ekspertët e pavarur do t'i shqyrtojnë të gjitha aplikacionet e dorëzuara. Negociatat përfundimtare dhe ndarja e granteve do të menaxhohen nga ZÇK/ZKM-ja.

ZÇK/ZKM-ja mbanë të drejtën për shpallje e çfarëdo numri të përfituesve apo që këtë mos ta bëjë fare. ZÇK/ZKM-ja nuk është përgjegjëse për çfarëdo shpenzimi që ka të bëjë me zhvillimin e projekt propozimeve.

IV.3. FINANCIMI

Shuma totale në dispozicion për këtë ftesë për propozim, është 100,000 Euro. **Financimi maksimal për një grant individual sipas kësaj ftese për propozim do të jetë deri 7,000 euro, dhe periudha maksimale e implementimit të projektit është 12 muaj.**

Buxheti duhet të jetë i përgatitur në euro dhe të jetë i bazuar në aktivitetet e përshkruara në aplikacion.

IV.4. METODAT E DORËZIMIT TË APLIKACIONEVE

Ekzistojnë dy metoda të mundshme të dorëzimit të aplikacioneve:

1. Aplikacionet mund të dërgohen me anë të postës elektronike në: zck-kpz-grants@rks-gov.net, me titullin vijues "MPDIK";
2. Aplikacionet mund të dorëzohen me dorë (të inxhizuar në CD) në adresën:

Zyra për Çështje të Komuniteteve
Zyra e Kryeministrit
Ndërtesa e Qeverisë
Zyra 606
Rruga Nëna Terezë
10000 Prishtinë

Republika e Kosovës

Në rast të dorëzimit të aplikacionit personalisht, aplikantët duhet të japin një kopje të shtypur të aplikacionit, si dhe një kopje elektronike në një CD-ROM. Materialet duhet të jenë në një zarf të mbyllur me emrin dhe adresën e aplikantit në qoshen e sipërme të majtë dhe të kenë të vendosur “MPDIK” në këndin e poshtëm të djathtë.

Aplikantët duhet t’i ruajnë kopjet për të dhënat e tyre, pasi që të gjitha aplikacionet e pranuar nuk do t’u kthehen më.

IV.5. PROCESI I SHQYRTIMIT

Aplikanti do ta paraqesë propozimin e plotë dhe buxhetin detajizuar deri në afatin e dhënë. Pas vlerësimit të propozimit të plotë dhe buxhetit të hollësishëm të projektit, ZÇK/ZKM-ja do të kryejë një vlerësim të mëtutjeshëm të kapaciteteve menaxheriale dhe financiare të organizatës. **ZÇK-ZKM-ja mbanë të drejtën për të kërkuar ndryshime në përshkrimin e projektit dhe të buxhetit të hollësishëm dhe do t’i ofrojë ndihmë teknike organizatës për t’i inkorporuar ndryshimet e kërkuara. Pastaj, projekt propozimet e ndryshuara dhe buxheti i hollësishëm do të vlerësohen sipas një vendimi përfundimtar.**

IV.5.1. Aplikacioni dhe buxheti i hollësishëm

Organizatat të cilat konkurrojnë duhet të paraqesin një projekt propozim të plotë dhe buxhetin e hollësishëm duke shfrytëzuar formularët e ZÇK/ZKM dhe duke iu përmbajtur specifikave të mëposhtme.

Aplikuesit duhet t’i zhvillojnë idetë për projektin e tyre dhe të hartojnë propozim projektin e tyre në bazë të kuptimit të nevojave të komuniteteve, duke shfrytëzuar përvojën e tyre paraprake. Aktivitetet duhet të zhvillohen me kujdes, pasi që aplikanti do të jetë përgjegjës për rezultatet specifike dhe financimi i ardhshëm do të varet nga arritja e rezultateve të propozuara.

Aplikacionet duhet të jenë në gjuhën shqipe ose serbe.

Aplikacionet duhet të dorëzohen duke shfrytëzuar vetëm formularin e ZÇK/ZKM-së. Aplikacionet e dorëzuara në format tjera nuk do të merren parasysh. Projekt propozimet e plota duhet t’i adresojnë qartë të gjitha informatat e kërkuara.

Projekt propozimet e plota nuk duhet t’i tejkalojnë 15 faqe.

1. Projekt propozimi (formulari i bashkangjitur)

1.1. Informacione themelore

1.2. Përmbledhje e projektit

- Historiku (deklarata e arsyeshmërisë/problemit dhe aktivitetet e jetësuar deri më tash);
- Përmbledhje e objektivave specifike, shtrirjes gjeografike, përfituesve të drejtpërdrejtë, aktiviteteve, rezultateve të pritura, përfshirë treguesit dhe ndikimin afatgjatë;
- Implementimi i projektit, përfshirë partneritetet (nëse ka); dhe
- Shpjegim i shkurtër se si aktivitetet e propozuara kontribuojnë në arritjen e objektivave dhe rezultateve të përgjithshme të **MPDIK**.

1.3. Kapacitetet menaxhuese

- Regjistrimi;

- Informacione të gjërësishme mbi organizatën tuaj dhe plani strategjik i zhvillimit të organizatës;
- Përvojën nga e kaluara në zbatimin e projektit, të ngjashëm me të propozuarin;
- Informacion mbi financimet e kaluara dhe aktuale;
- Informacion për stafin dhe ekipin në menaxhimin e financave;
- Ekipi i projektit;

1.4. Përshkrimi i projektit

- Rëndësia: Përshkrimi i problemit dhe lidhshmëria me objektivin e përgjithshëm të programit **MPDIK**;
- Objektivat e projektit tuaj dhe qëllimet specifike;

1.5. Aktivitetet dhe rezultatet

1.6. Përfituesit

1.7. Pjesmarrja lokale

- Përfshirja e qytetarëve
- Përfshirja e autoriteteve lokale

1.8. Dukshmëria e donatorëve (ZÇK/ZKM)

1.9. Qëndrueshmëria: rezultatet e projektit duhet të jenë të qëndrueshme dhe afatgjata

1.10. Monitorimi dhe vlerësimi i planit

1.11. Plani i veprimit

2. Buxheti i detajuar (formulari i bashkangjitur)

IV.5.2. KRITERET E VLERËSIMIT

Kriteret e paraqitura më lartë janë përcaktuar për nevojat e kësaj ftese për propozime. Për propozimin e kompletuar mund të fitohen 100 pikë. Rëndësia përkatëse e çdo kriteri është treguar me anë të rëndësisë së përafërt sipas pikave.

ZÇK/ZKM-ja do ta shqyrtoj aplikacionin dhe ta vlerësojë të njëjtën sipas kriterijumeve të elaboruar në tabelën më poshtë.

Aplikacionet do të vlerësohen sipas kriterëve të shënuara më poshtë për vlerësim teknik. Marrëveshja do të jetë e lidhur me paraqitësin e kërkesës, kërkesa e të cilit vlerësohet si më e qëlluar për ZÇK/ZKM. Aplikantët duhet ta kenë parasysh se këto kriterë: (1) shërbejnë si standard sipas të cilit të gjitha aplikacionet duhet të vlerësohen, dhe (2) shërbejnë për identifikimin e çështjeve të rëndësishme, të cilat aplikantët duhet t'i adresojnë në aplikacionet e tyre.

Ftesë për Propozime: Programi MPDIK

<p>Aplikacionet do të vlerësohen sipas shkallës prej 100 pikëve, si më poshtë: Kriteret e vlerësimit të aplikacionit</p>	<p>Rëndësia</p>
<p>Përmbushja e kushteve, kapaciteti i organizatës dhe përvoja në të kaluarën A e ka organizata të themeluar strukturën e nevojshme administrative dhe qeverisëse? A e ka organizata përvojë relevante për ta zbatuar projektin e propozuar?</p>	<p>10 pikë</p>
<p>Komunitetet / përfituesit e synuar të projektit Dëshmi se projekti merret me komunitetet jo-shumicë dhe me burimet vendore e institucionale; Dëshmia e pjesëmarrjes së komuniteteve jo-shumicë në projektimin, zhvillimin, zbatimin si dhe mbikëqyrjen dhe vlerësimin e programit; Sqarimi që femrat dhe të rinjtë do të marrin pjesë dhe të përfitojnë nga aktivitetet.</p>	<p>5 pikë</p>
<p>Arsyeja/arsyetimi i projektit A është sqaruar dhe arsyetuar mirë formulimi i problemit? A e identifikon iniciativa e propozuar problemin, nevojën apo mundësinë për ta adresuar nëpërmjet projektit?</p>	<p>10 pikë</p>
<p>Përpunimi dhe strategjia e projektit A i adreson projekti objektivat dhe rezultatet e pritura të programit të MPDIK -së? A e ka projekti qëllimin e përgjithshëm të qartë dhe relevant? A ka gjasa që projekti i propozuar të arrijë qëllimin dhe rezultatet e përcaktuara? A është projekti i dizajnuar në atë mënyrë që të bëjë ndërhyrjet ekzistuese dhe sqaroni se si do t'i plotësojë ato? A është strategjia e propozuar e realizueshme në lidhje me strukturën organizative dhe kërkesat buxhetore?</p>	<p>35 pikë</p>
<p>Rezultatet e parashikuara të projektit dhe përfitimet A janë rezultatet e pritura të lidhura me synimin e përgjithshëm? A janë artikuluar qartë përfitimet e popullatës së synuar?</p>	<p>15 pikë</p>
<p>Plani i mbikëqyrjes dhe vlerësimi i planit A ka projekti një plan të qartë për t'i matur rezultatet e projektit? A do të kryhet plani i mbikëqyrjes dhe vlerësimit në mënyrë pjesëmarrëse?</p>	<p>10 pikë</p>

Efektshmëria e kostos së buxhetit të propozuar A është buxheti koherent me aktivitetet e propozuara? A është buxheti i favorshëm në përputhje me shpenzimet? A janë të gjithë artikujt e buxhetit të përshkruar në mënyrë të qartë?	15 pikë
Totali	100 pikë

Një komision i përbërë nga anëtarët e personelit të ZÇK/ZKM-së dhe nga ekspertët e pavarur do të shqyrtojë propozimet sipas përmbushjes së objektivave dhe rezultateve në pajtueshmëri me kriteret e lartpërmendura.

V. KUSHTET DHE AFATET

V.1. MARRËVESHJA E DHËNJES SË GRANTIT

Marrëveshja e grantit do të përfshijë përshkrimin e projektit të miratuar, buxhetit të miratuar, kërkesave të raportuara dhe kushteve përkatëse. Me nënshkrim, kjo marrëveshje do të ketë efekt ligjor për ZÇK/ZKM-në dhe organizatën marrëse. Pas nënshkrimit të marrëveshjes së grantit, ajo nuk mund të ndryshohet pa miratimin paraprak dhe me shkrim nga ZÇK/ZKM.

V.2. LËSHIMI I MJETEVE TË GRANTIT DHE MENAXHIMI FINANCIAR

Marrësit e fondeve të grantit duhet të hapin një xhironlogari të veçantë bankare para se të gjitha fondet të transferohen nga ZÇK/ZKM. Grantet do të jepen në Euro dhe transferohen vetëm përmes transaksioneve bankare. Grantet do të jepen në disa këste, pas miratimit të raporteve periodike dhe përfundimtare. Sasia dhe data në të cilën çdo këst do të jepet, do të varet nga aktivitetet e projektit dhe do të fokusohet në marrëveshjen e grantit.

V.3. RAPORTIMI

Marrëveshja e grantit do t'i përcaktojë me hollësi kërkesat për raportim. Marrësit duhet të jenë të gatshëm t'i përmbahen orarit të raportimit dhe kërkesave, si për aktivitetet e programit ashtu edhe për mbikëqyrjen financiare.

V.4. MBIKËQYRJA

Stafi i ZÇK/ZKM do të mbikëqyrë ecurinë e programit. ZÇK/ZKM mban të drejtën për të rishikuar financat, shpenzimet dhe të gjitha dokumentet përkatëse në çdo kohë, gjatë periudhës së projektit dhe për tre vjet pas përfundimit të projektit dhe mbylljes së tij. Të gjitha faturat origjinale duhet të ruhen për tri vite pasi mbyllja zyrtare të jetë kompletuar.

V.5. DISPOZITAT STANDARDE

Nga ZÇK/ZKM kërkohet që të respektojë dispozitat ligjore dhe rregulloret të Republikës së Kosovës. MPDIK -ja do të administrohet sipas procedurave të Zyrës së Kryeministrit.

VI. DOKUMENTET E BASHKANGJITURA

Dokumentet e bashkangjitura në vijim konsiderohen si pjesë e kësaj ftese për propozime. Të gjitha formularët dhe udhëzimet si shtojcat e paraqitura më poshtë mund gjithashtu të pranohen me anë të postës elektronike nga: zck-kpz-grants@rks-gov.net

1. Formulari i projekt- propozimit
2. Formulari i buxhetit të hollësishëm